



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

**P.nr.776/2019**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.K..., nga fshati L.U..., komuna Gj..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1411/19, të datës 09.09.2019, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik, më datë 03.08.2023, mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri **S.K...**, nga babai H. dhe nëna A..., e gjinisë O..., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin L.U..., komuna e Gj..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, me nr.personal ..., me numër të telefonit 045/..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse më datë 20.02.2019, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpin e tij, në fshatin Livoq i Epërm, komuna e Gjilanit, i pandehuri S.K..., si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energji elektrike, ashtu që, fillimisht njëhsori elektrik i është shkyqur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-sit, i pandehuri, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse, në atë mënyrë që i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes të cilave është shpenzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar, me cka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm matërial në shumë prej rreth 73 euro.

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

### **DENIM ME KUSHT**

**I.** Të pandehurit S.K..., për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s, i caktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.** Pala e dëmtuar KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë paguaj paushallin gjyqësor në shumën pre 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A R S Y E T I M**

### **1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 09.09.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1411/2019, kundër të akuzuarit S.K..., nga fshati L.U..., komuna Gj..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar publik të datës 03.08.2023, prezent ishin prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i pandehuri S.K..., ndërsa ka munguar përfaqësuesi i të dëmtuarës, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.

### **2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 242 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, prandaj ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit S.K..., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri S.K..., ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s.

### **4. Elementet e veprës penale**

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin S.K..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

### **5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69,70 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin S.K..., si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i pandehuri është penduar, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale si dhe faktin se i njëjti ka lidhur marrëveshje me të dëmtuarën për pagimin e borxhit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se shkallën e përgjegjësinë penale.

### **6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit S.K..., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike**

Pala e dëmtuar KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

**8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 776/2023, më datën 03.08.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale,**  
Kadishe Ajvazi Demi

**Gjyqtari,**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE;** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

## NË EMËR TË POPULLIT A K T G J Y K I M

I pandehuri **S.K...**, nga babai Haki dhe nëna Adile, e gjinisë Osmanbashiq, i lindur më datë 03.01.1964, me vendbanim në fshatin L.U..., komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, me nr.personal 1005435923, me numër të telefonit 045/272-534, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 20.02.2019, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpin e tij, në fshatin Livoq i Epërm, komuna e Gjilanit, i pandehuri S.K..., si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energji elektrike, ashtu që, fillimisht njëhsoni elektrik i është shkyqur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-sit, i pandehuri, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse, në atë mënyrë që i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes të cilave është shpenzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar, me cka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm matërial në shumë prej rreth 73 euro.

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

### DENIM ME KUSHT

**I.** Të pandehurit S.K..., për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s, i caktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.** Pala e dëmtuar KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë paguaj paushallin gjyqësor në shumën pre 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 09.40 minuta.

V e r t e t o j n ë

Sek. juridike,

G j y k a t ë s i

